

## Shtojca 10

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[Data:14/08/2024]

Drejtuar: **“InfoSoft Office”** shpk me NIPT – **J62426002Q**

*Autostrada Tiranë- Durrës , km 8 Kashar-Tiranë*

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit **REF-13984-07-23-2024**: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Kancelari per Vitin 2024”, Kontrate Nje Vjecare, Fondi limit 4,436,652.2 (kater milion e katerqind e tridhjet e gjashte mije e gjashteqind e pesedhjet e dy pik dy) Leke, pa TVSH

Publikimet e mëparshme : NU KA: Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

Në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur 5 (pesë) oferta në mënyrë elektronike nga operatorë ekonomik si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik **“InfoSoft Office”** shpk me NIPT – **J62426002Q** me ofertë ekonomike 4,398,997 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik **“IT Gjergji Kompjuter”** shpk me NIPT - **K81503063B** me ofertë ekonomike 4,429,998 (katër milion e katëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik **“LIBRARI DYRRAHU”** shpk me NIPT – **L91418502J** me ofertë ekonomike 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik **“MARKETING & DISTRIBUTION”** shpk me NIPT – **J72124001N** me ofertë ekonomike 3,301,201 (tre milion e treqind e një mijë e dyqind e një) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik **“O F F I C E CENTER”** shpk me NIPT – **K41425042N** me ofertë ekonomike 3,028,166 (tre milion e njëzet e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë u konstatua se:

**Dokumentat e dërguara nga ana e operatorëve “InfoSoft Office” shpk, “IT Gjergji Kompjuter” shpk, “MARKETING & DISTRIBUTION” shpk, janë konform kritereve të kërkuara.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë u konstatua se:

**Dokumentat e dërguara nga ana e operatorëve “LIBRARI DYRRAHU” shpk, “O F F I C E CENTER” shpk nuk janë konform kritereve të kërkuara për arsyet si më poshtë:**

- Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk nuk plotëson kriterin e bardhësisë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST. Në shtojcën 7 pika 3.4/a të DST-së kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë: Skedë teknike nga prodhuesi ose distributori për produktin letër A4 sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit. Specifikimive teknike janë si më poshtë:

Nr	Artikujt	Specifikimet Teknike	Njësia/copë	Sasia
1	Letër A4 80 gr/m2	Pesha baze (min 78g/m2 max 82g/m2) Trashesi microns (min 98 max 108) CIE e Bardhësisë (min 144 max 150) Patejdukshmeria (min 90%) Ashpersia ml/min (min 150 max 300)	rismë	1

Për sa më sipër rezulton i pa plotësuar kriteri i bardhësisë ku në specifikimet teknike të kërkuara përcaktohet që artikulli Letër A4 të ketë CIE të Bardhësisë (min 144 max 150). Nga ana e Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk në skedën teknike të dorëzuar përcaktohet se Bardhësia C.I.E e letrës është objektivi 172 (min 169 max 175).

- Operatori ekonomik “O F F I C E CENTER” shpk nuk plotëson kriterin e përcaktuar në shtojcën 7 pika 3.3 të DST-së ku përcaktohet se: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike, janë të reja të pa përdorura. Në deklaratën e dorëzuar nga operatori ekonomik “O F F I C E CENTER” nuk është e shprehur që mallrat janë të reja dhe të papërdorura. Gjithashtu në shtojcën 7 pika 4 të DST-së përcaktohet se: Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të paraqesë autorizimin përkatës për paraqitjen e tyre si dhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf ose kuti. Nga ana e operatorit ekonomik “O F F I C E CENTER” në dorëzimin e mostrës nuk paraqiti një shkresë të vulosur dhe firmosur ku listohet mostra që ndodhet në zarf ose kuti.

Gjatë vlerësimit të kryer nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se operatorët ekonomik të kualifikuar pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur janë:

1. “InfoSoft Office” shpk me NIPT – J62426002Q me ofertë ekonomike 4,398,997 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. **“IT Gjergji Kompjuter”** shpk me NIPT - **K81503063B** me ofertë ekonomike 4,429,998 (katër milion e katëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
3. **“MARKETING & DISTRIBUTION”** shpk me NIPT – **J72124001N** me ofertë ekonomike 3,301,201 (tre milion e treqind e një mijë e dyqind e një) lekë pa TVSH.

Në mbështetje të ligjit Nr. 162/2020 neni 93 pika 5, i ndryshuar, Operatori ekonomik **“MARKETING & DISTRIBUTION”** shpk me NIPT – **J72124001N** me ofertë ekonomike 3,301,201 (tre milion e treqind e një mijë e dyqind e një) lekë pa TVSH, u skualifikua nga sistemi elektronik për shkak se rezultoi ofertë anomalisht e ulët.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit të operatorëve ekonomikë nga sistemi rezulton renditja e operatorëve si më poshtë:

1. **“InfoSoft Office”** shpk me NIPT – **J62426002Q** me ofertë ekonomike 4,398,997 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
2. **“IT Gjergji Kompjuter”** shpk me NIPT - **K81503063B** me ofertë ekonomike 4,429,998 (katër milion e katëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“InfoSoft Office”** shpk me NIPT – **J62426002Q** *Autostrada Tiranë- Durrës , km 8 Kashar-Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4,398,997 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH. është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.